

URDHËR
Nr. 872, datë 29.10.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE TË SHFAQUR NË SHTETIN E TURQISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
 - a) të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra;
 - b) materialit biologjik dhe të pa shoqëruar me test diagnostik PCR të rezultuar negativ, i bashkëlidhur me certifikatën shëndetësore veterinare, të kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;
 - c) mishit të freskët;
 - d) produkteve të mishit, të patrajtuara me të paktën një temperaturë prej 70°C për 30 minuta;
 - e) qumështit dhe produkteve të qumështit të patrajtuara termikisht, me një temperaturë minimale prej 72° C për 15 sekonda (temperaturë e lartë – kohë e shkurtër pasterizimi (HTST) e aplikuar 2 herë) ose çdo trajtim tjetër ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;
 - f) leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të papërpunuara, të patrajtuara ose papërpunuara ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;
 - g) ushqimit me përmbajtje proteinike dhe ushqimit të kafshëve ruminantë dhe derra të patrajtuara termikisht ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike,sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të tabelës së mëposhtme të shtetit të Turqisë:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Sivas*	Ulaş*	
Sivas*	Akıncılar*	
Sivas*	Yıldızeli*	
Sivas*	Altınyayla*	
Sivas*	Kangal*	
Sivas*	Doğanşar*	
Sivas*	Gürün*	
Sivas*	Merkez*	
Sivas*	İmranlı*	
Diyarbakır*	Merkez*	
Konya*	Kadınhanı*	
Konya*	Ereğli*	
Tunceli*	Pülümür*	
Tunceli*	Pertek*	
Denizli*	Çal*	
Denizli*	Çivril*	
Erzurum*	Şenkaya*	
Erzurum*	Çat*	
Erzurum*	Uzundere*	
Erzurum*	Hınıs*	
Erzurum*	Karaçoban*	

Erzurum*	Aşkale*	
Erzurum*	Tekman*	
Erzurum*	İlca*	
Erzurum*	İspir*	
Afyon*	Sandıklı*	
Afyon*	Dinar*	
Afyon*	Bolvadin*	
Afyon*	Sincanlı*	
Afyon*	Sultandağı*	
Afyon*	Merkez*	
Afyon*	İhsaniye*	
Batman*	Kozluk*	
Isparta*	Yalvaç*	
Isparta*	Keçiborlu*	
Isparta*	Gönen*	
Isparta*	Merkez*	
Isparta*	Şarkikaraağaç*	
Izmir*	Seferihisar*	
Izmir*	Bayındır*	
Aydın*	Germencik*	
Aydın*	İncirliova*	
K. Maras*	Elbistan*	
Burdur*	Merkez*	
Burdur*	Karamanlı*	
Burdur*	Bucak*	
Aksaray*	Eskil*	
Aksaray*	Güzelyurt*	
Aksaray*	Gülağaç*	
Aksaray*	Merkez*	
Adana*	Tufanbeyli*	
Adana*	Karataş*	
Adana*	Aladağ*	
Trabzon*	Maçka*	
Rize*	İkizdere*	
Kütahya*	Simav*	
Kütahya*	Aslanapa*	
Kütahya*	Emet*	
Konya*	İlgın*	
Konya*	Altınekin*	
Konya*	Tuzlukçu*	
Konya*	Derbent*	
Kırşehir*	Akpınar*	
Kırşehir*	Akçakent*	
Kırşehir*	Merkez*	
Kayseri*	Sarıoğlan*	
Kayseri*	Yahyalı*	
Kayseri*	Akkışla*	
Kayseri*	Pınarbaşı*	

Erzincan*	Otlukbeli*	
Erzincan*	Üzümlü*	
Iğdır*	Karakoyunlu*	
Bingöl*	Yedisu*	
Erzincan*	Çayırılı*	
Erzincan*	Tercan*	
Erzincan*	Otlukbeli*	
Erzincan*	Merkez*	
Nevşehir*	Kozaklı*	
Nevşehir*	Gülşehir*	
Van*	Erciş*	
Mus*	Bulanık*	
Mus*	Merkez*	
Mus*	Varto*	
Malatya*	Yazıhan*	
Malatya*	Merkez*	
Mardin*	Savur*	
Kars*	Arpaçay*	
Kars*	Merkez*	
Kars*	Sankamış*	
Kars*	Digor*	
Elazığ*	Merkez*	
Elazığ*	Karakoçan*	
Elazığ*	Alacakaya*	
Elazığ*	Kovancılar*	
Adıyaman*	Gölbasi*	
Adıyaman*	Gerger*	
Nevşehir**	Merkez*	
Eskisehir*	İnönü*	
Eskisehir*	Sivrihisar*	
Agri*	Merkez*	
Agri*	Tutak*	
Hakkari*	Merkez*	
Siirt*	Şirvan*	
Van*	Gürpınar*	
Afyon*	Dazkırı*	
Van*	Merkez*	

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra, materialit biologjik, embrioneve, mishin e freskët, produktet dhe nënprodukteve të tyre, qumështin, produktet e qumështit, mielli i mishit, mielli i gjakut, leshit, qimeve,

lëkurëve dhe lëkurëve të trajtuara dhe të papërpunuara, dhe ushqimit të kafshëve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra.

3. Urdhri nr. 675, datë 6.9.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Turqisë”, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj